



SHOQATA E ARKITEKTËVE TË SHQIPËRISË

Ref. shash\_100118\_VKA

24/01/2021

Tiranë

### Lënda: Anëtarësimi në SHASH 2021

Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë, ju fton për anëtarësim për të vitin 2021, për të qenë më shumë në numër dhe për të kontribuar së bashku drejt përmirësimit të rolit të arkitektit/urbanistit në shoqëri, tregun e projektimit dhe në vendimarrjet politike.

Tarifat vjetore për periudhën Janar-Shkurt 2021 për anëtarësimin në disa kategori janë si më poshtë:

Kategoria I (Arkitekt):	6000 I/vit
Kategoria II (Arkitekt i Asociuar):	2000 I/vit
Kategoria III (Arkitekt Ndërkombëtar):	60.0 €/vit
Kategoria IV (Grupe Interesi Kombëtare):	4500 I/vit
Kategoria V (Studio e Liçensuar Projektimi):	9000 I/vit
Kategoria VI (Student):	500 I/vit

Anëtarësimi në SHASH është i hapur 25 Janar 2021 - 31 Mars 2021.

Anëtarët e 2021 do të përfitojnë:

1. Pjesëmarrje të lehtësuara në aktivitete të ndryshme kulturore dhe profesionale.
2. Njoftime periodike në aktivitetet e SHASH
3. Njoftime mbi aktet ligjore që lidhen në fushën e projektimit
4. Njoftime për punësim në studiot e projektimit dhe zbatimin
5. Dhe shumë të tjera

Pajisja me kartën e anëtarësimin:





**Cilësimi mbi kriteret e anëtarësimit vjen si më poshtë:**

**Kategoria I – Arkitekt (Architect)**

Në këtë kategori përfshihen arkitektët dhe urbanistët e pajisur me licensë profesionale.

Kandidati për këtë kategori duhet të dorëzoj:

- a. mandatin e pagesës për anëtarësim (fotokopje/skanim)
- b. licensën profesionale (fotokopje/skanim)
- c. formularin e aplikimit
- d. diplomë (fotokopje/skanim)

Anëtari i kësaj kategorie:

- ka të drejtë të marrë pjesë në votim për përzgjedhjen e kryesisë së ShASH
- ka të drejtë të informohet në mënyrë elektronike për çdo vendim, të reja, aktivitete, problematika të ndryshme nga ShASH.

**Kategoria II – Arkitekt i Asociuar (Associate Architect)**

Në këtë kategori përfshihen studentët e diplomuar por që nuk janë pajisur me licensë (deri në dy vite pas diplomimit sipas normave të ushtrimit të profesionit).

Kandidati për këtë kategori duhet të dorëzoj:

- a. mandatin e pagesës për anëtarësim (fotokopje/skanim)
- b. formularin e aplikimit
- c. diplomë (fotokopje/skanim)

Anëtari i kësaj kategorie:

- ka të drejtë të marrë pjesë në votim për përzgjedhjen e kryesisë së ShASH
- ka të drejtë të informohet në mënyrë elektronike për çdo vendim, të reja, aktivitete, problematika të ndryshme nga ShASH

**Kategoria III – Arkitekt Ndërkombëtar (International Architect)**

Në këtë kategori përfshihen arkitektët dhe urbanistët e pajisur me licensë profesionale në vendin e tyre (jashtë kufijve të Shqipërisë).

Kandidati për këtë kategori duhet të dorëzoj:

- a. mandatin e pagesës për anëtarësim (fotokopje/skanim)
- b. licensën profesionale (fotokopje/skanim)
- c. formularin e aplikimit
- d. diplomë (fotokopje/skanim)

Anëtari i kësaj kategorie:

- nuk ka të drejtë të marrë pjesë në votim për përzgjedhjen e kryesisë së ShASH
- ka të drejtë të informohet në mënyrë elektronike për çdo vendim, të reja, aktivitete, problematika të ndryshme nga ShASH.



## SHOQATA E ARKITEKTËVE TË SHQIPËRISË

### Kategoria IV – Individë Përkrahës Kombëtare (National Allied Individual)

Në këtë kategori përfshihen individë të cilët nuk kanë diplomë në arkitekturë dhe urbanistikë, por kanë fusha interesi të përbashkët si psh: restaurim, mjedisor, pejsazhi, inxhinieri, klima, trashëgimia, historia, artet, dizajni etj. Janë një grup mjaft i gjerë por që lidhen indirekt me tematikat e arkitekturës, sikurse edhe arkitekti, urbanisti lidhet anasjelltas me to.

Kandidati për këtë kategori duhet të dorëzoj:

- a. mandatin e pagesës për anëtarësim (fotokopje/skanim)
- b. formularin e aplikimit
- c. diplomë (fotokopje/skanim)

Anëtari i kësaj kategorie:

- ka të drejtë të marrë pjesë në votim për përzgjedhjen e kryesisë së ShASH
- ka të drejtë të informohet në mënyrë elektronike për çdo vendim, të reja, aktivitete, problematika që lidhen me fushën e interesit nga ShASH.

### Kategoria V – Studio e Liçensuar Projektimi (Architectural/Urban Design Studio)

Në këtë kategori përfshihen studio e liçensuar projektimi (arkitekturë dhe urbanistikë) të cilët kanë NIPT.

Kandidati për këtë kategori duhet të dorëzoj:

- a. mandatin e pagesës për anëtarësim (fotokopje/skanim)
- b. formularin e aplikimit
- c. diplomë (fotokopje/skanim)
- d. liçensën profesionale (fotokopje/skanim)
- e. liçensën QKR/NIPT (fotokopje/skanim)

Anëtari i kësaj kategorie:

- është / janë pronarët e studios
- ka të drejtë të marrë pjesë në votim për përzgjedhjen e kryesisë së ShASH
- ka të drejtë të informohet në mënyrë elektronike për çdo vendim, të reja, aktivitete, problematika nga ShASH.
- Ka të drejtë të publikoj në web të SHASH punimet e tyre, oferta punësimi , në mënyrë direkte apo dhe të linkuar me faqen web të studios

### Kategoria VI – Studente (Student)

Në këtë kategori përfshihen student në arkitekturë dhe urbanistikë.

Kandidati për këtë kategori duhet të dorëzoj:

- a. mandatin e pagesës për anëtarësim (fotokopje/skanim)
- b. formularin e aplikimit
- c. vërtetim që janë student nga fakultete të akredituara (fotokopje/skanim)

Anëtari i kësaj kategorie:

- nuk ka të drejtë të marrë pjesë në votim për përzgjedhjen e kryesisë së ShASH



## SHOQATA E ARKITEKTËVE TË SHQIPËRISË

- ka të drejtë të informohet në mënyrë elektronike për çdo vendim, të reja, aktivitete, problematika nga ShASH.

### **Shënim:**

- Ata anëtarë që janë regjistruar në vitin 2019, mjaftojnë të kryejnë pagesën vjetore.
- Në rast se anëtarët e regjistruar në 2019 kanë ndryshuar të dhënat, atëherë është e domosdoshme plotësimi edhe një here I formularit, dhe më pas do të pajiseni me një kartë të re anëtarësimi, por kodi i anëtarësimit mbetet i njëjtë.
- Për kategorinë Student, tarifa e regjistrimit mbetet 500 L/vit për anëtarët e rinj që do të regjistrohen në 2020, ndërsa për anëtarët e 2019 kjo tarifë vjetore do të jetë 0 L/vit.

**Kryesia  
SHASH**